

VENDIM
Nr.162, datë 28.2.2008

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.94, DATË 30.4.2007 TË KUVENDIT “PËR
MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE ORGANIKËS SË ENTIT RREGULLATOR TË
SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË
NDOTURA (ERRU)”**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, neneve 9 pika 2 dhe 10 pika 1 të ligjit nr.9584, datë 17.7.2006 “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, me propozimin e Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU),

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Në vendimin nr.94, datë 30.4.2007 të Kuvendit “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU)”, lidhja nr.2 “Organika e Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura” zëvendësohet me lidhjen nr.2 bashkëlidhur.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

**ORGANIKA E DETAJUAR E ENTIT RREGULLATOR TË SEKTORIT TË
FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA
(ERRU)**

KOMISIONI I ERRU-SË	Kategoria e pagës	Numri i punonjësve	
KRYETARI			1
ANËTARË KOMISIONI			4
Sekretarja e Komisionit dhe Kryetarit			
1			
DREJTORIA TEKNIKO-EKONOMIKE			8
Drejtor drejtorie		1	
Sektor Teknik dhe IT			
Përgjegjës sektori	III-a		1
Specialist i rrjeteve inxhinierike të ujësjellësve dhe ITUP	III-b	1	
Specialist i rrjeteve inxhinierike të KUZ dhe ITUZ	III-b		1
Specialist i licencave dhe IT	III-b		1
Sektori Ekonomik dhe Monitorues			
Përgjegjës sektori	III-a		1
Specialist i vlerësimit të kostos dhe tarifave	III-b		1
Specialist i monitorimit dhe verifikimit të treguesve të punës	III-b		1
Sektori Juridik dhe i Marrëdhënieve me Publikun			
Përgjegjës sektori	III-a/1		1
Specialist	III-b		1
Sektori i Administratës, Financës dhe Burimeve Njerëzore			
Përgjegjës sektori	III-a/1		1
Specialist finance	III-b		1
Punonjës mbështetës			
Arkivist-protokollist			1
Shoferë			2
			21